



*Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)*



Aspekte të zbatimit të Rregullores No. 1896/2006 “Mbi krijimin e procedurës së urdhrit european për pagesë”: vendimmarrja, njoftimi, kundërshtimi i një urdhri european për pagesë

TRAJNIM

**PËRMBUSHJA DHE EKZEKUTIMI I DETYRIMEVE NDËRKUFITARE NË BE PËRDORIMI EFIKAS I
PROCEDURAVE NDËRKUFITARE EUROPIANE**

Tiranë, 12 -13 Dhjetor 2020

Përgatiti: Dr. Silvana Çinari



*Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)*



Përmbajtja

- A. Procedura e shqyrtimit të aplikimit për një urdhër european për pagesë: aspekte të vendimmarrjes
- B. Njoftimi i urdhrit european për pagesë
- C. Kundërshtimi i urdhrit european për pagesë



Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)



A. Procedura e shqyrtimit të aplikimit për një urdhër european për pagesë: aspekte të vendimmarrjes

Gjykata që shqyrton aplikimin për urdhër european për pagesë:

- Verifikon nëse aplikimi bie në fushën e zbatimit të rregullores 1896/2006, (n. 2) është një rast ndërkufitar (n. 3), lidhet me një detyrim monetar të maturuar (n. 4), ka juridiksion (n. 6), përmbush kërkesat formale të përcaktuara në nenin 7 dhe nuk është *prima facie* i pabazuar;
- Nuk bën vlerësim të provave apo të informacionit të siguruar nga paditësi në formularin e aplikimit.



*Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)*



A. Procedura e shqyrtimit të aplikimit për një urdhër european për pagesë: aspekte të vendimmarrjes

- Në varësi të rezultatit të shqyrtimit të aplikimit për urdhër european për pagesë, gjykata mund të marrë vendim për:
 1. Ndryshimin e aplikimit/pranimin pjesërisht të tij
 2. Refuzimin e aplikimit
 3. Pranimin e aplikimit dhe lëshimin e urdhrit european për pagesë



Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)



A. Procedura e shqyrtimit të aplikimit për një urdhër european për pagesë: aspekte të vendimmarrjes

1. **Ndryshimi i aplikimit/pranimi pjesërisht i tij (n. 10)**

- Nëse gjatë shqyrtimit të aplikimit për urdhër european për pagesë rezulton se plotësohen kushtet vetëm për një pjesë të padisë gjykata informon paditësin duke përdorur formularin standard C.
- Paditësi ftohet të pranojë ose refuzojë propozimin për një urdhër european për pagesë për shumën e përcaktuar nga gjykata.
- Gjkata cakton afat për kthimin e përgjigjes nëpërmjet formularit standard C.
- Paditësi informohet për pasojat e vendimit të tij.



Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)



A. Procedura e shqyrtimit të aplikimit për një urdhër european për pagesë: aspekte të vendimmarrjes

1. **Ndryshimi i aplikimit/pranimi pjesërisht i tij (n. 10)**

Pasojat e (mos)përgjigjes së paditësit:

- a. Lëshim i urdhrit european për pagesë për pjesën e padisë të pranuar nga paditësi kur:
 - paditësi pranon propozimin e gjykatës
- b. Refuzim i urdhrit european për pagesë në tërësi në rast:
 - Moskthim përgjigje brenda afatit të caktuar nga gjykata;
 - Refuzim të propozimit të gjykatës brenda afatit të caktuar prej saj.
- Pasojat në lidhje me pjesën e mbetur të padisë fillestare rregullohen nga ligji kombëtar.



Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)



A. Procedura e shqyrtimit të aplikimit për një urdhër european për pagesë: aspekte të vendimmarrjes

2. Refuzimi i aplikimit për urdhër european për pagesë (n. 11)

Shkaqet e refuzimit:

- Aplikimi nuk bie në fushën e zbatimit të rregullores 1896/2006, ose
- Aplikimi nuk lidhet me një çështje ndërkufitare, ose
- Aplikimi nuk lidhet me një detyrim monetar të maturuar, ose
- Gjykata nuk ka juridiksion, ose
- Aplikimi nuk përmbush kërkesat formale të përcaktuara në nenin 7, ose
- Padia është *prima facie* e pabazuar, ose
- Aplikimi nuk është plotësuar apo korigjuar brenda afatit të caktuar nga gjykata, ose
- Padiësi nuk përgjigjet brenda afatit të caktuar nga gjykata lidhur me propozimin e saj për të ndryshuar aplikimin.



Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)



A. Procedura e shqyrtimit të aplikimit për një urdhër european për pagesë: aspekte të vendimmarrjes

2. Refuzimi i aplikimit për urdhër european për pagesë (n. 11)

Gjykata ka të drejtë të shqyrtojë *ex officio* nëse norma e interesave të caktuar në kontratë është një klauzolë e padrejtë në përputhje me Direktivën 93/13/KEE 'Për kushtet e padrejta në kontratat konsumatore' dhe për rrjedhojë të rrëzojë aplikimin për urdhër european për pagesë si haptazi të pabazuar.

[Vendim i Gjykatës (Dhoma e Parë), 14 Qershor 2012 në çështjen C-618/10 *Banco Español de Crédito, SA v Joaquín Calderón Camino*]



*Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)*



A. Procedura e shqyrtimit të aplikimit për një urdhër evropian për pagesë: aspekte të vendimmarrjes

2. Refuzimi i aplikimit për urdhër evropian për pagesë (n. 11)

- Padiësi informohet për shkaqet e refuzimit me anë të formularit standard D.
- Sipas Rregullores 1896/2006, kundër refuzimit të aplikimit nuk lejohet ankim. Kjo nuk përjashton, megjithatë, një rishikim të mundshëm në përputhje me ligjin kombëtar.
- Refuzimi i aplikimit nuk e ndalon padiësin të bëjë një aplikim të ri për një urdhër evropian për pagesë ose të ndjekë ndonjë procedurë tjetër të disponueshme sipas ligjit të një Shteti Anëtar.



Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)



A. Procedura e shqyrtimit të aplikimit për një urdhër european për pagesë: aspekte të vendimmarrjes

- **3. Lëshimi i urdhrit european për pagesë (n. 12)**
- Nëse nga shqyrtimi i aplikimit rezulton se plotësohen të gjitha kërkesat, gjykata lëshon urdhrin european për pagesë duke përdorur formularin standard E.
- Afati: 30 ditë nga depozitimi i aplikimit, pa përfshirë kohën që i është dashur paditësit të plotësojë, korrigjojë, apo ndryshojë aplikimin.
- Përmbajtja: Urdhri duhet të tregojë se:
 - I padituri ka mundësi (i) për t'i paguar paditësit shumën e treguar në urdhër ose (ii) për të kundërshtuar urdhrin duke paraqitur në gjykatën e origjinës një deklaratë kundërshtimi
 - urdhri u lëshua vetëm në bazë të informacionit të siguruar nga paditësi dhe nuk u verifikua nga gjykata;
 - urdhri do të bëhet i zbatueshëm nëse nuk është depozituar një deklaratë kundërshtimi në gjykatë
 - kur paraqitet një deklaratë kundërshtimi, procesi do të vazhdojë para gjykatave kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës në përputhje me rregullat e procedurës së zakonshme civile, përveç nëse paditësi ka kërkuar në mënyrë të qartë që procedurat të ndërpriten në atë rast.



Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)



A. Procedura e shqyrtimit të aplikimit për një urdhër european për pagesë: aspekte të vendimmarrjes

- **3. Lëshimi i urdhrit european për pagesë (n. 12)**
- Urdhrit i bashkëngjitet formulari i aplikimit
- Gjykata siguron që urdhri t'i njoftohet të paditurit në përputhje me ligjin kombëtar me një metodë që duhet të përmbushë standardet minimale të përcaktuara në nenet 13, 14 dhe 15.



Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)



B. Njoftimi i urdhrit european për pagesë

Mënyrat e njoftimit sipas Rregullores 1896/2006 (n. 13-15)

1. **Njoftimi me provë marrjeje nga i padituri/përfaqësuesi** – karakterizohen nga siguria e plotë që dokumenti i njoftuar ka arritur tek marrësi i tij:
 - a. **Personal** – i vërtetuar:
 - i. nga një vërtetim marrjeje, që përfshin datën e marrjes, i cili nënshkruhet nga i padituri, ose
 - ii. nga një dokument i nënshkruar nga personi kompetent që ka kryer njoftimin që deklaron se i padituri ka marrë dokumentin ose ka refuzuar ta marrë atë pa ndonjë shkak të ligjshëm, dhe datën e dorëzimit;
 - b. **Me postë** – i vërtetuar nga një vërtetim marrjeje, që përfshin datën e marrjes, nënshkruhet dhe kthehet nga i padituri;
 - c. **Elektronik** – p.sh. faksi ose posta elektronike (e-mail), e vërtetuar me një vërtetim marrjeje, që përfshin datën e marrjes, nënshkruhet dhe kthehet nga i padituri.



Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)



B. Njoftimi i urdhrit european për pagesë

Mënyrat e njoftimit sipas Rregullores 1896/2006 (n. 13-15)

2. Njoftim pa provë marrjeje nga i padituri/përfaqësuesi:

- e aplikueshme vetëm nëse adresa e të paditurit dihet me siguri;
 - Në legjislacionet e brendshme të disa shteteve njihet si mënyrë njoftimi për shtetasin që ka vendqëndrimin e zakonshëm jashtë shtetit dorëzimi i akteve në zyrën e prokurorit (*remise au parquet*). Kjo mënyrë është e papajtueshme me standardet e Rregullores 1896/2006
- karakterizohet nga një mundësi shumë e lartë që i padituri të ketë marrë njoftim



B. Njoftimi i urdhrin european për pagesë

Mënyrat e njoftimit sipas Rregullores 1896/2006 (n. 13-15)

2. Njoftim pa provë marrjeje nga i padituri/përfaqësuesi:

- a. Në adresën e banimit të të paditurit familjarëve që banojnë dhe personave që punojnë atje vetëm nëse këta persona e pranojnë/marrin urdhrin european për pagesë, vërtetuar me vërtetim marrjeje;
 - b. Në ambientet e biznesit të të paditurit personave të punësuar, në rastin e një të padituri të vetëpunësuar ose person juridik, vetëm nëse këta persona e pranojnë/marrin urdhrin european për pagesë, vërtetuar me vërtetim marrjeje;
 - c. Në kutinë postare të të paditurit;
 - d. Në zyrë postare ose tek autoritetet publike kompetente **dhe** vendosja në kutinë postare të të paditurit të njoftimit me shkrim të atij depozitimi, me kusht që njoftimi me shkrim të përcaktojë qartë karakterin e dokumentit si dokument gjyqësor ose efektin ligjor të njoftimit
- Në të gjitha këto raste kryerja e njoftimit vërtetohet me një dokument të nënshkruar nga personi kompetent që ka kryer njoftimin, duke treguar mënyrën e njoftimit të përdorur, datën e njoftimit, dhe kur urdhri i është dorëzuar një personi tjetër përveç të paditurit (rastet a dhe b), emrin e personit që i është dorëzuar dokumenti dhe marrëdhëniet e tij me të paditurin.



*Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)*



B. Njoftimi i urdhrit european për pagesë

Mënyrat e njoftimit sipas Rregullores 1896/2006 (n. 13-15)

2. Njoftim pa provë marrjeje nga i padituri/përfaqësuesi :

- e. Njoftim postar pa provë marrjeje kur i padituri ka adresë në Shtetin Anëtar të origjinës.

- f. Njoftim elektronik me konfirmim automatik dorëzimi, **me kusht** që i padituri ta ketë pranuar shprehimisht këtë metodë të njoftimit paraprakisht.



*Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)*



B. Njoftimi i urdhrorit european për pagesë

Mënyrat e njoftimit sipas Rregullores 1896/2006 (n. 13-15)

Neni 27 i Rregullores 1896/2006

“Kjo rregullore nuk do të ndikojë në zbatimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 1348/2000 të datës 29 maj 2000 mbi njoftimin në Shtetet Anëtare të dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në çështjet civile dhe tregtare “

Rregullorja (KE) Nr. 1348/2000 është shfuqizuar nga Rregullorja (KE) Nr. 1393/2007



Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)



B. Njoftimi i urdhrit european për pagesë

Kur një i urdhër european për pagesë i dorëzohet të paditurit pa pasur të bashkangjitur aplikimin për urdhër të shkruar në një gjuhë që i padituri mendohet se e kupton ose të pa shoqëruar nga një përkthim, siç kërkohet nga neni 8 (1) i rregullores nr. 1393/2007, i padituri duhet të informohet siç duhet, me anë të formularit standard në Aneksin II të Rregullores Nr. 1393/2007, për të drejtën e tij për të refuzuar të pranojë dokumentin në fjalë.

Nëse kjo kërkesë formale shkelet, procedura e njoftimit duhet të rregullohet në përputhje me dispozitat e Rregullores Nr. 1393/2007, duke i komunikuar të paditurit formularin standard në Aneksin II të kësaj rregulloreje.

Në këtë rast, si rezultat i parregullsisë procedurale që ndikon në njoftimin e urdhrit european për pagesë së bashku me aplikimin për urdhrin, urdhri nuk bëhet i ekzekutueshëm dhe afati në të cilin i padituri mund të paraqesë një deklaratë kundërshtimi nuk mund të fillojë të ecë, prandaj neni 20 i Rregullores Nr. 1896/2006 nuk mund të zbatohet.

[Catlin Europe SE v O.K. Trans Praha spol. s r.o. (Çështja C-21/17)]



*Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)*



B. Njoftimi i urdhrit european për pagesë

- Mënyrat e mësipërme të njoftimit aplikohen gjithashtu edhe ndaj përfaqësuesit të një të padituri (n. 15) si në rastet e përfaqësimit ligjor, ashtu dhe në rastet e përfaqësimit vullnetar. (Recitali 22 i Preambulës)



Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)



C. Kundërshtimi i urdhrit evropian për pagesë

- I padituri mund të paraqesë një deklaratë kundërshtimi ndaj urdhrit Evropian për pagesë në gjykatën e origjinës duke përdorur formularin standard F, por dhe çdo formë tjetër të shkruar nëse kundërshtimi shprehet në mënyrë të qartë. (Recitali 23 i Preambulës)
- Mënyra e dorëzimit të deklaratës:
 - formë dokumenti të shkruar, ose
 - me ndonjë mjet tjetër komunikimi, përfshirë elektronik, të pranuar nga Shteti Anëtar i origjinës dhe i disponueshëm për gjykatën e origjinës.
- Deklarata e kundërshtimit do të nënshkruhet nga i padituri ose, kur është e zbatueshme, nga përfaqësuesi i tij. Kur deklarata e kundërshtimit paraqitet në formë elektronike, ajo do të nënshkruhet në përputhje me nenin 2 (2) të Direktivës 1999/93 / EC, me përjashtim kur ekziston një sistem alternativ i komunikimit elektronik në gjykatat e Shtetit Anëtar të origjinës. Shtetet Anëtare informojnë Komisionin për sisteme të tilla të komunikimit.
- I padituri nuk ka nevojë të specifikojë arsyet e kundërshtimit në deklaraten e kundërshtimit.



Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)



C. Kundërshtimi i urdhrit european për pagesë

- **Afati i dorëzimit të deklaratës së kundërshtimit:**
 - brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të urdhrit të paditurit
 - Për qëllim të llogaritjes së afatit duhet të zbatohet Rregullorja (KEE, Euratom) Nr. 1182/71 e Këshillit, e 3 Qershorit 1971, që përcakton rregullat e zbatueshme për periudhat, datat dhe afatet.
 - Dita e njoftimit nuk përfshihet kur llogaritet afati
 - Nëse afati përfundon të shtunë, të djelë ose në ditë festash zyrtare afati shtyhet ditën e nesërme të javës
 - Vetëm festat zyrtare të Shtetit Anëtar ku lëshohet urdhri merren në konsideratë
 - Mbyllja e gjykatave për arsye të pushimeve zyrtare nuk ndikon në ecjen e afateve



Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)



C. Kundërshtimi i urdhrit european për pagesë

Pasoja e paraqitjes së deklaratës së kundërshtimit: (n. 17)

- Përveç kur paditësi ka kërkuar shprehimisht që procesi të pushohet, ai do të vazhdojë para gjykatave kompetente të Shtetit Anëtar të origjinës, sipas:
 - a. Procedurës Europiane të Padive të Vogla të përcaktuara në Rregulloren (KE) Nr. 861/2007, nëse është e zbatueshme; ose
 - b. çdo procedure civile kombëtare të përshtatshme.



Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)



C. Kundërshtimi i urdhrit european për pagesë

- Procesi do të transferohet në një proces civil kombëtar përshtatshëm, përveç nëse paditësi ka kërkuar shprehimisht që një transferim i tillë të mos bëhet, kur:
 - paditësi nuk ka treguar se cilën nga procedurat kërkon të zbatohet në procesin që pason në rast të një deklaratë kundërshtimi, ose
 - kur paditësi ka kërkuar që Procedura Europiane e Padive të Vogla siç përcaktohet në Rregulloren (KE) Nr. 861/2007 të zbatohet për një padi që nuk bie brenda fushës së asaj Rregulloreje.
- Kur paditësi ka ndjekur procedurën e urdhrit Evropian për pagesë, asgjë sipas ligjit kombëtar nuk do të paragjykojë pozicionin e tij në procesin civil të mëpasshëm.
- Transferimi në proceset civile rregullohet nga ligji i Shtetit Anëtar të origjinës.
- Paditësi informohet nëse i padituri ka paraqitur një deklaratë kundërshtimi dhe për çdo transferim në procesin civil.



Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)



C. Kundërshtimi i urdhrit europian për pagesë

Kur një i paditur nuk kundërshton juridiksionin e gjykatës së Shtetit Anëtar të origjinës në deklaratën e tij të kundërshtimit të urdhrit europian për pagesë, ai kundërshtim nuk mund të prodhojë, në lidhje me atë të paditur, efekte të tjera nga ato që rrjedhin nga neni 17 (1) të Rregullores Nr. 1896/2006. Këto efekte konsistojnë në përfundimin e procedurës së urdhrit europian për pagesë dhe - përveç nëse paditësi ka kërkuar shprehimisht që procedurat të ndërpriten në atë rast - në transferimin automatik të çështjes në procedurat e zakonshme civile.

Neni 6 i Rregullores (KE) Nr. 1896/2006, lexuar së bashku me nenin 17 të saj, duhet të interpretohet se deklarata e kundërshtimit të një urdhri europian për pagesë që nuk përmban asnjë kundërshtim për juridiksionin e gjykatës së Shtetit Anëtar të origjinës nuk mund të konsiderohet se përbën pranim të juridiksionit me paraqitje në kuptim të Nenit 24 të Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 44/2001 dhe fakti që i padituri, në deklaratën e paraqitur të kundërshtimit, ka paraqitur argumente në lidhje me themelin e çështjes, është i parëndësishëm në atë drejtim.

[Çështja C-144/12, Goldbet Sportëetten GmbH v Massimo Sperindeo, para. 31, 44]



*Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)*



C. Kundërshtimi i urdhrit european për pagesë

Pasoja e mosparaqitjes së deklaratës së kundërshtimit: (n. 18)

- Gjykata e origjinës deklaron urdhrin european për pagesë të ekzekutueshëm pa vonesa duke përdorur formularin standard G, nëse brenda afatit 30 ditor, duke marrë parasysh një periudhë të përshtatshme kohore për të lejuar mbërritjen e një deklarate, i padituri nuk paraqet deklaratën e kundërshtimit.
- Gjykata i dërgon paditësit urdhrin e ekzekutueshëm european për pagesë.



*Train 2 EN4CE Project is being funded by the
European Union's Justice Programme (2014-2020)*



FALEMINDERIT!